



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE**

Rr. "Agim Ramadani", Ndërtesa e Fakulteteve Teknika, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: [fim@uni-pr.edu](mailto:fim@uni-pr.edu)

Ueb: <https://fim.uni-pr.edu/>

Nr. Prot: 2306

Datë: 03 / 12 / 2025

Këshilli i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës, në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 56 dhe rregullore Nr. 1/437 datë 18.05.2018 mbi themelimin dhe parimet e funksionimit të Trupës Këshill-dhënëse në mbledhjen e mbajtur më 26.11.2025

Miraton:

**RREGULLOREN**  
**E TRUPËS KËSHILL-DHËNËSE ME PËRFAQËSUES NGA INDUSTRIA**  
**E FAKULTETIT TË INXHINIERISË MEKANIKE**  
**TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS**

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Qëllimi

Trupi Këshillëdhënës me përfaqësues nga industria (në vijim "Këshilli") ka për qëllim të forcojë bashkëpunimin ndërmjet fakultetit dhe sektorit të industrisë, të sigurojë që programet akademike përputhen me nevojat e tregut të punës, si dhe të kontribuojë në rritjen e cilësisë së arsimit, kërkimit dhe inovacionit në fushën e inxhinierisë mekanike.

### Neni 2

#### Përbërja

Këshilli përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) deri në 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarë :

- Përfaqësues të sektorëve kryesorë të industrisë: Prodhimtari dhe inxhinieri Industriale, Dizajn inxhinierik dhe automjete, Termoenergjetikë dhe energji e ripërtëritshme, Komunikacion dhe transport, Mekatronikë;
- Përfaqësues nga fakultetet tjera teknike;
- Përfaqësues të qendrave kërkimore ose instituteve bashkëpunuese;
- Përfaqësues nga sektori publik dhe privat, OJQ;
- Studentë ose përfaqësues të të diplomuarve.

### Neni 3

#### Detyrat dhe përgjegjësitë

##### 3.1. Këshillimi për kurrikulën

- Rishikon dhe jep rekomandime për përditësimin e programeve të studimit në të gjitha ciklet;
- Sugjeron lëndë të reja, aftësi praktike dhe kompetenca të nevojshme për tregun e punës;
- Jep feed-back mbi përmbajtjen laboratorike dhe praktike të programeve.

##### 3.2. Bashkëpunimi me industrinë

- Nxist formimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet fakultetit dhe kompanive industriale nga fushat përkatëse;
- Identifikon mundësi për praktika profesionale, trajnim, internship dhe vizita studimore;
- Sugjeron partneritete për projekte të përbashkëta.

### 3.3. Punësimi dhe zhvillimi i karrierës

- Jep informacione mbi profilin e punëtorit të kërkuar nga industria;
- Ndhmon në organizimin e panairëve të karrierës dhe sesioneve të rekrutimit;
- Mbështet zhvillimin e aftësive të buta dhe teknike të studentëve.

### 3.4. Kërkimi shkencor dhe inovacioni

- Identifikon fusha me potencial të lartë kërkimor dhe inovativ;
- Siguron dhe sugjeron tema të projekteve të diplomës me relevancë industriale;
- Mbështet projekte kërkimore me bashkëfinancim ose linja teknike.

### 3.5. Transferimi i teknologjisë

- Konsulton fakultetin mbi investimet në laboratorë, pajisje dhe teknologji të reja;
- Ndhmon në transferimin e njohurive dhe inovacioneve nga industria në akademi dhe anasjelltas;

### 3.6. Vlerësimi i programeve akademike

- Merr pjesë në proceset e akreditimit dhe rishikimit të programeve të studimit;
- Ofron vlerësime të performancës së të diplomuarve në tregun e punës.

### 3.7. Zhvillimi strategjik i fakultetit

- Jep rekomandime për strategjinë afatgjatë të fakultetit;
- Analizon trendët teknologjike për të orientuar zhvillimin e ardhshëm të programeve dhe laboratorëve.

### 3.8. Promovimi i aktiviteteve profesionale

- Nxist organizimin e trajnimeve, seminareve dhe punëtorive të specializuara;
- Siguron ligjërues të jashtëm ose ekspertë të industrisë për tema të avancuara.

## Neni 4

### Mënyra e funksionimit

- Këshilli mbledhet të paktën dy herë në vit;
- Mbledhjet mund të thirren edhe me kërkesën e Dekanit ose shumicës së anëtarëve;
- Vendimet janë këshilluese, por duhet të protokollohen dhe i përcillen strukturave përkatëse të fakultetit.

## Neni 5

### Mandati

- Anëtarët nga industria emërohen për një mandat 2–3 vjeçar, me mundësi riemërimi, por edhe me mundësi zëvendësimi në rast të mungesës së vazhdueshme (2 deri në 3 takime);
- Mandati i anëtarëve nga radhët e stafit akademikë përcaktohet nga organet menaxhuese të fakultetit.

## Neni 6

### Raportimi

- Këshilli përgatit një raport vjetor me rekomandime konkrete për kurrikulën, investimet laboratorike, bashkëpunimet me industrinë dhe zhvillimin strategjik të fakultetit;
- Raporti i dorëzohet Dekanit dhe Këshillit të Fakultetit.

## Neni 7

### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Dekani i FIM-UP-së.

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit

Prof. Mirlind Bruçi, Dekan

